



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 77, datë 30.05.2016

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 34, DATË 28.05.2015
“PËR RAPORTIMIN E DETYRUAR VJETOR DHE PERIODIK TË SHOQËRIVE TË
SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT”, E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 111 dhe 146, pika 5, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Në Rregulloren nr. 34, datë 28.05.2015 “Për raportimin e detyruar vjetor dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit”, bëhen ndryshimet sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI

Ndryshimet në Rregulloren nr. 34, datë 28.05.2015 “Për raportimin e detyruar vjetor dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit” janë si më poshtë:

1) Në nenin 2, pas fjalës “nenit 111” shtohet togfjalëshi “dhe pikës 5 të nenit 146”;

2) Neni 4, pika 1, germa a) riformulohet:

“Pasqyra financiare 3 mujore (raportohet me bazë tremujore);

Kjo pasqyrë, si rregull, raportohet deri më 31 Janar të vitit pasardhës për vitin dhe brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, për periudhat e ndërmjetme. Pasqyrat FI 17Q, 18Q, 19Q, 20Q dhe 21Q raportohen në çdo rast brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tremujori. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të pasqyrave financiare 3 mujore përcaktohen në aneksin 1, të kësaj rregulloreje.”

3) Neni 4, pika 1, germa b) riformulohet:

“Raport mbi Aktivitet në mbulim të Provigjoneve Teknike (raportohet me bazë tremujore)

Kjo pasqyrë, si rregull, raportohet deri më 31 Janar të vitit pasardhës për vitin dhe brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, për periudhat e ndërmjetme. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të raportit mbi aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike përcaktohen në aneksin 2, të kësaj rregulloreje.”

4) Neni 4, pika 1, germa c) riformulohet:

“Raport mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit (raportohet me bazë tremujore)

Kjo pasqyrë, si rregull, raportohet deri më 31 Janar të vitit pasardhës për vitin dhe brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, për periudhat e ndërmjetme. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të raportit mbi mjaftueshmërinë e kapitalit përcaktohen në aneksin 3, të kësaj rregulloreje. Kjo pasqyrë raportohet në të njëjtat afate kohore dhe në të njëjtën formë dhe për grupet e sigurimet sipas përkufizimeve të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014.”

5) Neni 4, pika 1, germa d) riformulohet:

“Statistika 3 mujore (raportohet me bazë tremujore).

Këto pasqyra, si rregull, raportohen deri më 31 Janar të vitit pasardhës për tremujorin e fundit dhe brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, për tremujorët e tjerë. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të statistikave 3 mujore përcaktohen në aneksin 4, të kësaj rregulloreje.”

6) Neni 4, pika 1, germa f) riformulohet:

“Statistika vjetore (raportohet me bazë vjetore)

Këto pasqyra, si rregull, raportohen deri më 31 Janar të vitit pasardhës. Forma, përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të statistikave vjetore përcaktohen në aneksin 6, të kësaj rregulloreje.”

7) Neni 4, pika 1, germa g) ndryshohet:

“Të dhëna teknike 3 mujore (raportohet me bazë tremujore)

Kjo pasqyrë, si rregull, raportohet deri më 31 Janar të vitit pasardhës për vitin dhe brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tre mujori, për periudhat e ndërmjetme. Forma,

përmbajtja dhe mënyra e plotësimit të të dhënave teknike 3 mujore, përcaktohen në aneksin 7, të kësaj rregulloreje.”

8) Në tabelën FI 9.1 krahas fjalëve shoqëri sigurimi do të shtohet togfjalëshi “/grup sigurimi”.